



WESTERN BALKAN NETWORK
ON TERRITORIAL GOVERNANCE

Thirrje për publikime

Qeverisja Territoriale në Ballkanin Perëndimor, 2021, numri i tretë

Nëpërmjet kësaj thirrjeje ne ftojmë të gjithë të interesuarit në çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen territoriale, të dorëzojnë abstrakte për publikimin e artikujve në numrin e tretë të periodikut Qeverisja Territoriale në Ballkanin Perëndimor.

Qeverisja Territoriale në Ballkanin Perëndimor botohet nga Co-PLAN dhe Universiteti POLIS një herë në vit, në gjuhën angleze, në version të shtypur dhe në medime online (<http://www.co-plan.org/en/tg-review/>).

Artikujt bazohen në punë kërkimore shkencore dhe vlerësime ekspertësh. Artikujt synojnë të prodhojnë njohuri që ndikon formësimin e politikave publike në Ballkanin Perëndimor në lidhje me qeverisjen territoriale dhe çështje të tilla si planifikimi i territorit, integrimi Evropian dhe Evropianizimi, mjedisi, ndryshimet klimatike dhe reziliencë, energjia, transporti, trashëgimia kulturore, financat publike, zhvillimin rajonal, etj.

Tema

Qeverisja Territoriale në Ballkanin Perëndimor përmban artikuj në formën e dokumenteve të shkurtra të politikave, ku propozohen zgjidhje autentike apo huazime të praktikave më të mira ndërkombëtare për zbatim në analiza të konteksteve të vendeve të Ballkanit. Artikujt sugjerohet të kenë një qasje krahasuese për çështje të qeverisjes territoriale në dy ose më shumë vende të Ballkanit Perëndimor, ose të trajtojnë çështje të cila janë me relevancë për të gjitha vendet.

Për vitin 2021, Tematika Editoriale e botimit fton autorët të publikojnë artikuj në fushën e resilience, pasigurive dhe qeverisjes e planifikimit me përshtatje. Artikuj të cilët fokusohen në qeverisjen e rrezeve dhe riskut të fatkeqësive në territor, ndikimet e ndryshimeve klimatike, dhe të etikës në planifikim dhe menaxhim burimesh në kushtet e krizave, janë veçanërisht subjekt i publikimit të këtij viti.

Udhëzime

Ju lutem dërgoni një abstrakt prej maksimumi 200 fjalësh në anglisht, me një bibliografi të shkurtër, emrin/at e autorit/ëve (ku specifikohet përkatësia institucionale dhe autori kryesor, nëse ka më shumë se një) në një dokument, bashkëngjitur email-it në adresat ledio_allkja@co-plan.org dhe co-plan@co-plan.org brenda datës **2 Prill 2021**. Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni po në adresat e mësipërme.



WESTERN BALKAN NETWORK
ON TERRITORIAL GOVERNANCE

Afatet kohore

Dorëzimi i abstrakteve nga autorët	2 Prill, 2021
Dërgimi i konfirmimeve të pranimit të abstraktit dhe i udhëzimeve editoriale	15 Prill, 2021
Dorëzimi i artikujve të plotë nga autorët	28 Qershor, 2021
Dërgimi i komenteve për rishikimin e artikujve	31 Korrik, 2021
Dorëzimi i artikujve të plotë të rishikuar nga autorët	15 Shtator, 2021

*Publikimi i periodikut parashikohet të kryhet brenda datës 30 nëntor 2021.

** Të gjithë artikujt kalojnë nëpër një proces të dyfishtë rishikimi.

Botimet e Qeverisja Territoriale në Ballkanin Perëndimor, 2019 dhe 2020 gjenden në

<http://www.co-plan.org/en/tg-review/>